



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

Nr. 5432/ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **BOE Farma Net Albania sh.p.k** me NIPT **K92201080V**, Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Siri Kodra”, ndërtesë 2-katëshe, me zonë kadastrale 8340 dhe Nr.pasurie 8/660, kati 1, dhe **Florfarma sh.p.k** me NIPT **K21405001N** Adresa: Tiranë, Rr. “Qazim Vathi” Nr.72, me përfaqësues Farma Net Albania Sh.p.k.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur me mjete elektronike-mallra.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 91498-10-25-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje barna dhe materiale konsumi për Qendrat Shëndetësore që bllokohen gjatë dimrit” (viti 2018), me fond limit 17,096,055 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë e pesë) Lekë pa TVSH.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkim Operatorësh Farma Net Albania sh.p.k me NIPT K92201080V, dhe Florfarma sh.p.k me NIPT K21405001N me përfaqësues Farma Net Albania Sh.p.k, me vlerë oferte totale 16,591,372 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
2. Egian Med sh.p.k me NIPT L71715003C, me vlerë oferte totale 16,745,324.8 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e njëzet e katër,8) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Egian Med sh.p.k** me NIPT L71715003C

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, **pika 2.e** kërkohet “Ofertuesi duhet të plotësojë edhe formularin e ofertës për një qendër shëndetësore (Shtojca 1/1 Aneksi I i DST)”. **OE nuk ka dorëzuar** formularin e ofertës të plotësuar për një Qendër shëndetësore, sipas shtojcës 1.1, por ka dorëzuar vetëm formularin e ofertës sipas shtojcës 1.
2. Në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, **pika 2.4.1.** kërkohet “Për barnat (e listës së DST) të autorizuarra për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet vetëdeklarim që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim brenda afatit të vlefshmërisë të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”. **OE ka paraqitur vetëdeklarim që barnat e autorizuarra për tregtim janë të pajisur me autorizim por nuk ka bashkëlidhur listën me barnat**

përkatëse, sic e ka plotësuar në formularin e ofertës. Kjo bën të pamundur verifikimin e listës së barnave që subjekti ka deklaruar në formularin e ofertës, me ato të kërkuara në DST.

3. Në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, **pika 2.4.2**, Për barnat (e listës së DST) të paaautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, kërkohet: **1) Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA. Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë leshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, ëeb-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi. 2) Autodeklarate per origjinën e mallit ku te percaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese/MAH (të plotësohet në shtojcën 1 të Formularit të Ofertës). 3) Autorizim nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) ose prodhuesi ose distributori i autorizuar; nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë **barnat e pikës 2.4.2**”. OE **nuk ka plotësuar** asnjë nga kriteret e sipërcituara për artikujt **Nr. 17 dhe Nr. 26** në listën e barnave të cilët rezultojnë si barna të paaautorizuara për tregtim. Për artikullin **Nr. 12 nuk ka plotsëuar** kriterin **1) dhe 3)** por vetëm kriterin **2)** duke përcaktuar vendin e prodhimit dhe kompaninë prodhuese/MAH në shtojcën 1 të Formularit të Ofertës.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE Ekonomikë Farma Net Albania sh.p.k** me NIPT **K92201080V**, Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga “Siri Kodra”, ndërtesë 2-katëshe, me zonë kadastrale 8340 dhe Nr.pasurie 8/660, kati 1, dhe **Florfarma sh.p.k** me NIPT **K21405001N** Adresa: Tiranë, Rr. “Qazim Vathi” Nr.72, me përfaqësues Farma Net Albania Sh.p.k, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **16,591,372 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH** /pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ 5 _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.11.2018

Ankesa: jo

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arian Kraja